VENDIM
Nr. 63, datë 1.11.2017

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA BANKA INTESA SANPAOLO S.P.A., ITALI, TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË VENETO BANKA SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "gj", të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, dhe të pikës 18, të shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe finan-ciare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 100 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Veneto Banka sh.a. nga Banka Intesa Sanpaolo S.p.A., Itali.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko